

# DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



## KRYETARI I DHOMËS SË BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE/ PROJEKTE KONKRETE TË INVESTIMIT NË SHQIPËRI

Kryetari i Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare z.Ardian Lekaj në një intervistë për televizionin “SCAN” ka folur për krijimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare në një periudhë jo të lehtë për Shqipërinë. “Ne jemi krijuar në tërmet dhe jemi zhvilluar në pandemi kjo padiskutim na bën më të fortë”. Fillimisht Dhoma ka bërë mbledhjen e informacionit pasi Diaspora Shqiptare është e shpërndare dhe është kryesorja për të nisur punën duke qenë se detyra kryesore është ndërtimi i urave lidhëse. “Ka shembuj konkretë të investitorëve nga Diaspora ka dhe shembuj konkret të rritjes së eksporteve nga Shqipëria. Kuptohet që bimët mjekësore kanë qenë gjithmonë një produkt shqiptar që ka dhe ka goxha emër të mirë, por që do kalojmë në një stad tjetër.

**PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI:** >>>>



## SHQIPËRI/100 MLN EURO INVESTIME NË “BROADBAND”, RRIJIN PUNËSIMIN DHE PBB

Një studim i Komisionit Europian për “Ndikimin e Transformimit dixhital në Ballkanin Perëndimor”, tregon se me 100 milionë euro investime në zhvillim broadband do të shtohen 10 mijë vende të reja pune dhe mund të ndikojë me 0.9% në rritjen ekonomike të vendit. Studimi thotë se Shqipëria ka potencialin më të lartë të punësimit nga investimet me bandë të gjerë, se në vendet e tjera për arsye të nevojave ende të larta për rrjete të reja të internetit, sidomos në zonat rurale. Investimet në ekonominë dixhitale gjithashtu përmirësojnë produktivitetin në një seri shërbimesh si publike dhe private dhe gjithashtu sjellin përfitime ekonomike nga sektorë të tjerë. Gjatë vitit 2020, kriza e COVID-19 ka çuar në një nxitje të madhe drejt dixhitalizimit të ekonomisë shqiptare.

**PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI:** >>>>



## PAVARËSISHT PANDEMISË, REMITANCAT NË TREND RRI TËS

Banka e Shqipërisë ka prezantuar botimin e saj të fundit me studime për remitancat, të titulluar “Pandemia dhe Remitancat”. Remitancat ndihmojnë politikën fiskale, duke ndikuar në shtimin e konsumit në nivelet e PBB-së dhe TVSH-së. Ato mbështesin po ashtu sektorin financiar, duke liruar aksesin në kushtet e kredisë, politikën monetare, por edhe tregun e punës, duke dhënë mbështetje për të vetëpunësuarit dhe duke përbërë burim të rëndësishëm financimi për biznesin e vogël. Banka e Shqipërisë, në botimin e saj “Pandemia dhe Remitancat”, thekson se “Remitancat, në kontekstin e zhvillimeve aktuale ekonomike, mbeten një potencial i madh për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik shqiptar, prandaj ato duhet të karakterizohen dhe trajtohen si resurse dhe si një kategori thelbësore në ekonomi.

**PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI:** >>>>



## JAVA NË LAJME

NISMA “DHURO LIBRA”, NIS PROCESI I SHPËRNDARJES NË GREQI DHE ITALI



STOP DEPORTIMIT TË EMIGRANTËVE NGA GREQIA!



PLANI I VEPRIMIT TË STRATEGJISË PËR DIASPORËN MBLIDHET GRUPI I KOORDINATORËVE



## KURSI I KËMBIMIT

MONEDHA	BLERJE	SHITJE
USD	101.8	102.6
EUR	123.3	123.9
CHF	112.9	113.7
GBP	142	142.9
DKK	16 <sup>.25</sup>	16.66